

Klinika Kirurgjikale Austriake
Kirurgji e përgjithshme - Estetikë - Ortopedi - Orl

“SPITALI KIRURGJIK AUSTRIAK” SH.P.K

Rr. Komuna e Parisit, Nr.3 – Tirane Tel: 0682090472

Nr. _____ Prot

Date ____/____/2015

Lenda: Njoftim per nisjen e procedures per aplikim per Leje Mjedisi Tipi “B”

Drejtuar: AGJENCISE KOMBETARE TE MJEDISIT

TIRANE

NJESISE BASHKIAKE NR.5
BASHKIA TIRANE

TIRANE

AGJENCISE RAJONALE TE MJEDISIT QARKU TIRANE

TIRANE

Une, **Astrit Kuçani**, me cilesine e administratorit te shoqerise “Spitali Kirurgjik Austriak” Sh.p.k., qe ushtron veprimtari ne fushen e sherbimeve mjeksore ambulare, spitalore dhe terciare jo publike., po ju drejtohem me kete shkrese, me ane te se ciles dua te njoftoj fillimin e procedures per pajisje me leje mjedisore te tipit “B” si me poshte vijon.

Ne objektin e marre me qira, ne adresen: Rruga “Komuna e Parisit”, nr.3 Tirane, ne kemi ngritur Siptalin Kirurgjik Austriak, ne te cilen ofrohen sherbime mjeksore ambulare, spitalore dhe jo terciare.

Mbeshtetur ne Kreun III, dhe Kreun VI te VKM Nr. 419, date 25.06.2014 “Per miratimin e kerkesave te posaçme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipit A, B dhe C”, po dergojme njoftimin perfillimin e procedures per pajisjen me leje mjedisore per aktivitetin qe ne parashikojme te ushtrojme:

Bashkelidhur ketij njoftimi do te gjeni:

1. Informacionin ne lidhje me kerkesen dhe llojin e Lejes Mjedisore qe duhet te pajiset ky aktivitet
2. Ekstraktin e Regjistrimit Tregtar te leshuar nga QKR
3. Adresen e vendndodhjes se instalimit
4. Pershkrimin e veprimtarise qe zhvillohet ne instalim
5. Pershkrim te shkurter te elementeve te listuar ne formularin informues
6. Autoritetin vendimmarres per dhenien e aktit te miratimit te lejes se mjedisit, procedurat dhe afatet qe do te ndiqen
7. Adresen e Agjencise Kombetare te Mjedisit

Duke pritur vazhdimin e metjshem te procedurave,

Me konsiderate,

Astrit KUÇANI

Perfaqesues Ligjor

1. Informacionin ne lidhje me kerkesen dhe llojin e Lejes Mjedisore qe duhet te pajiset ky aktivitet

Referuar Ligjit Nr.10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", i ndyshuar me ligjin Nr.60/2014, shtojca 1,

- Veprimtarite te tjera
- ID 12.2 - Spitalet.

Leje Tipit "B" – Te gjitha instalimet

Per sa me sipër, Leja Mjedisore qe duhet pajiset kjo veprimtari duhet te jete LEJE MJEDISORE – Tipi "B".

2. Te dhena te ekstraktit te leshuar nga QKR

Sipas Ekstraktit te regjistrimit tregtar te leshuar nga QKR, po japim me poshte te dhenat e subjektit:


NIPT-i:	K72422002V
Data e Rregjistrimit:	22-12-2007
Data e themelimit:	16.07.2014
Emri i Subjektit:	"Spitali Kirurgjik Austriak" Sh.p.k.
Selia e shoqerise:	Rr. "Komuna e Parisit", Nr.3 – Tirane.
Administrator:	Astrit Kuçani
Ortaket:	Astrit Kuçani 100% te aksioneve
Objekti i aktivitetit:	sherbime mjeksore ambulatorore, spitalore dhe jo terciare.

Bashkelidhur do te gjeni nje kopje origjinale te Ekstraktit te Regjistrimit Tregtar te Leshuar nga QKR.

3. Adresa e Vendndodhjes se instalimit

Rr. "Komuna e Parisit", Nr.3 – Tirane, Njesia Bashkiake Nr.5, Bashkia Tirane
(Përballe ekspozitës " Shqipëria sot", në krah të pazarit të fshatareve)





Spitali Austriak



4. Pershkrim i veprimtarise qe parashikohet te zhvillohet ne instalim

Spitali Kirurgjik Austriak (Subjekti) shpk është i regjistruar në QKR Tiranë me seli në rrugën “Komuna e Parisit”, Nr.3, Tirane me NIUS K72422002V, ofron shërbimet ambulatorore dhe spitalore në ambientet e selisë së saj në përputhje me licencat dhe autorizimet e marra nga autoritetet përkatëse shtetërore.

Subjekti disponon faqen zyrtare të tij ne internet. Me anë të faqes zyrtare Subjekti transmeton dhe mbledh informacione.

Nëpërmjet kësaj faqe Subjekti prezanton shërbimet, ambientet dhe terminet në të cilat ato ofrohen. Prezantohet informacioni i përgjithshëm në lidhje me historikun dhe me objektivat e aktivitetit.

Subjekti e konsideron mbrojtjen e të dhënave personale një çështje të rëndësishme së veçantë, lidhur ngushtë me etikën dhe cilësinë e shërbimit.

Qëllimi i mbledhjes së informacionit

Mbledhja e informacionit ka si qëllim realizimin e shërbimit sa më cilësor ndaj pacientit. Nëpërmjet këtij informacioni krijohet mundësia e lënies së termineve me mjekët e specializuar, transmetimi kërkesave, vërejtjeve dhe propozimeve nga ana e pacientëve.

Aktiviteti i Klinikës

Në këtë klinike kryhen të gjitha ndërhyrjet e kirurgjisë së përgjithshme. Si kirurgjia e



hernieve, variceve, hemorroideve (me një metode të re pa plage të jashtme e pa dhimbje), kolecista me metoden laparoskopike, struma e gjëndrës tiroide, kirurgjia e kancerit të gjirit.

Kirurgjia plastike si: heqje dhjami me liposuktion, heqje e lëkurës së tepërt të barkut, zvogëlim ose zmadhim të gjoksit, lifting të fytyrës etj. Ndërhyrje ortopedike si: artroskopi të gjurit dhe e shpatullës, gishta e

shtrembër të këmbëve, ndërhyrje në dorë, proteza kokso femorale të gjurit dhe të shpatullës, riparimi i kërcit me nje metode moderne.

Gjithashtu kryhen dhe ndërhyrje Orl si korrigjimi i deviacionit dhe estetik të hundës, paracenteza, etj.

Personeli i klinikës

Ekipi i kirurgeve perbehet nga kirurge te mirenjohur austriake. Te gjithë me nje eksperience mbi 20 vjecare pune, kirurge aktive ne kryesisht ne Viene dhe Graz me nje aktivitet pune mbi 1000 paciente ne vit.

Personeli i mesem mjeksor eshte krejtesisht shqipetar. Nje kombinim ndermjet infermiereve te reja e atyre me eksperience do siguroje mbarvajtjen ne aktivitetin ditor ne klinike. Disiplina e punes austriake do te jete modeli te cilin ne do te ndjekim.

Aktiviteti spitalor

Laparoskopi (Fshikza e temthit)

Ne kete rast behet fjale per semundjen e krijimit te gureve ne qesen e fshikezes se temthit pra kolecistes. Kjo eshte nje semundje shume me e perhapur tek grate ne raport 3:1 me burrat. Ne pjesen me te madhe te rasteve guret kane permbajtje kolesteroli e krijohen nga marrja e ushqimeve me shume yndyre , nje fenomen ky shume i perhapur i kohes sone.

Gjate qendrimit per nje kohet te gjate te gureve ne fshikez krijohen infeksione te here pas hershme te fshikezes, te ashtuqjtura kolecistitis. Symptomat kryesore jane dhimbjet ne pjesen e djathte te siperme te barkut, me teper pas marrjes se ushqimeve me shume yndyre apo te skuqura si dhe me permbajtje te larte te vezeve. Ne rastet kur guret jane te vogla 2-3 mm atehere mund te ndodhe rreshqitja e tyre ne kanal kryesor,koledok,qe sjell si rrjedhoje mbylljen akute te ketij kanali, grumbullimin e lengut te temthit ne rruget e temthit. Kjo shoqerohet me simptoma te forta dhimbjeje,kolika biliare, si dhe nganjehere edhe me verdhez si pasoje e futjes se lengut biliar ne qarkullinin e gjakut.

Operacioni konsiston ne heqjen e plote te fshikezes se temthit e cila ne kliniken tone do te behet me menyren laparoskopike, pra me 4 plage te vogla 2-3 cm nepermjet asistences se nje kamere dhe ekrani televiziv.

Pacientet kane nje perfitim te madh nga kjo metode, kane shume pak dhimbje pas operacionit e mund te rifillojne aktivitetin ditor brende 10 ditesh. Per arsye te plageve te vogla evitohen edhe herniet e cikatriceve qe jane aq te perhapura ne metoden e hapur.

Vetem ne raste te rralla, kur gjate operacionit kirurgu gjendet perballe situatave te papritura , si infeksione te medha te kolecistes, ngjitje te komplikuara te organeve te tjera mbi koleciste apo krijimi i gjakderdhjeve gjate operacionit, duhet qe operacioni te perfundohet me metoden e hapur pra me nje prerje rreth 10 cm nen harkun brinjor te djathte.

Hemorroidet

Ketu behet fjale per nje rrjet venoz ne zonen e anusit,i cili per arsye te ndryshme, si : trashegimia, ndenja per nje kohe te gjate ne kembe apo ulur, marrja e ushqimeve te tharta apo te pasura me djegesira e piper,alkooli,pirja e duhanit e tjere, sjell ne zgjerimin e tyre. Simptomat kryesore jane: dhimbje ne rregjonin anal, gjakderdhje, kruajtje perreth anusit, veshtiresi gjate defekimit e tjere.

Jo rralle ne moshat e perparuara fshihet pas gjakderdhjes ndonje proces tumoroz i zorres se trashe,per kete arsye eshte e nevojshme perpara operimit te hemorroideve te kryhet nje kolonoskopi,pra ekzaminim i zorres se trashe, ne menyre qe te mos humbet kohe e cmuar per heqjen e kesaj patollogjije.

Ne kliniken tone do te kryhet nje metode e re operacioni e quajtur " Anopexie sipas metodes Longo".Me kete metode behet prerja dhe qepja e hemorroideve me nje aparat " Stapler", i cili ka aftesine ti presi e ti qepi ne te njejten kohe. Operacioni

kryhet 3-4 cm mbi hyrjen e anusit, pra nuk krijohen plage te jashtme te dhimbshme , fenomen shume i padisherueshem ne metodat e tjera te operimit te hemorroideve.

Pacientet mundet te shkojne po ne ditën e operacionit ose nje dite me vone ne shtepi, e rreth 1 jave pas operacionit pacienti mundet ti rikthehet aktivitetit te tij ditor. Suksesi i ketij operacioni eshte vertetuar mijra here nga pacientet e operuar nga kirurget e klinikes sone ne spitalin St. Elisabeth ne Viene.

Komplikacionet jane shume te rralla e ne pjesen me te shumte konsistojne ne gjakderdje te vogla pas operacionit , gje qe evitohet lehte ne nje operacion te shkurter gjate te cilit gjehet ky vend e reparohet.

Analfistel

Ne kete semundje behet fjale per nje lidhje direkt te kanalit anal me lekuren ne afersi te anusit. Arsye per kete jane absese qe krijohen rreth anusit te cilet pasi operohen ose zbrazen vete lene nje kanal lidhes i cili vazhdimisht prodhon lengje te qelbezuara ose edhe gjak.

Keto fistula nuk sherohen asnjehere pa operacion, perkundrazi edhe kur operacioni eshte kryhen me sukses ekziston mundesia e nje perseritje e nevojiten disa operacione.

Pjesa me e madhe e fistulave kalon nepermes sfinkterit anal e ne raste te rralla mundet qe pas operacioneve te kete nje humbje e funksionit te tij qe sjell si pasoje humbjen e feceve te holla e gazrave nemenyre te pavullneteshme.

Herniet

Ne kete rast behet fjale per daljen e permbajtjes se brendeshme te barkut jashte murit mbrojtës se tij permes nje kanali natyral qendodhet ne rreze te kofshes ne fund te barkut, ne te ashtuquajturen kanal inkuinal. Ne kete kanal kalon te meshkujt tubi spermatik ndersa tek femrat nje ligament terheqes qe mban te terhequr miren. Raporti i hernieve midis meshkujve e femrave eshte rreth 5:1.

Jo rralle eshte si permbajtje e qeses se hernies nje pjese e zorres se holle, asj te trashe apo tek pleqte e fshikezes se urines. Ne rastet kur reponimi i permbajtjes se hernies, pra rifutja ne bark nuk eshte me e mundur, krijohet nje klinike akute qe ne qofte se nuk operohet menjehere mund te coje deri ne nekrotizim te permbajtjes kerkon prerjet e kesaj pjese te zorres. Per kete arsye keshillohet qe operacioni i hernies te behet menjehere pas vendosjes se diagnozes, per te mos lejuar krijimin e komplikacioneve. Te pleqte jo rralle eshte dalja e nje hernie si shenja e pare e nje tumori te zorres se trashe i cili ngre presionin brenda barkut e sjell krijimin e hernies. Per kete arsye eshte e domosdoshme qe perpara operacionit te behet nje kolonoskopi per te perjashtuar ndonje patollogji te zorres se trashe.

Operacioni i hernieve e reparon kete defekt ne murin e barkut .Metodat jane te ndryshme. Ne kohet e fundit jane bere shume te shpeshta operacionet me perforcim te kanalit nepermjet nje rrjete sinestetike e cila tek metoda " Lichtenstein" vendoset permbi faqen muskulore, pra behet me nje plage te vogel ne fund te barkut , ose nen shtresen muskulore, ne menyre laparoskopike. Ne rastin e fundit plaget e operacionit

jane minimale, 3 plage te vogla rreth 0,5 cm qe i japin mundesi pacientit te rifilloje aktivitetin e tij ditor shume shpejt dhe kane nje efekt kosmetik shume me te mire. Ne te dy metodat, te cilat do te kryhen ne kliniken tone rezidivat, pra rishfaqja, eshte shume e rralle.

Varicet

Ketu behet fjale per venat (damaret) e gjakut te kembeve te cilat per arsye te ndryshme, duke filluar nga trashegimia deri tek profesionet e shoqeruara me qendrim te gjate ne kembe apo ulur, semuren e zgjerohen. Muret e venave hollohen e humbin elasticitetin ,ne kete menyre humbasin aftesine per te transportuar gjakun venoz te kembeve ne drejtim te zemres.

Si pasoje krijohen vena te dukshme nen lekure qe ne raste te rralla infektohen ose bllokohen nga thrombe ,te ashtuquajturat thromboflebitis,gje qe paraqet nje suate te rrezikshme per pacientin. Ne pjesen me dermuese te rasteve behet fjale per nje varikoze te venave kryesore, ne pjesen e perparme te kembes eshte vena safena magna e ne pjesen e pulpes, vena safena parva.

Keto jane vena me kllapa, te cilat ne kushte normale lejojne rrjedhje e gjakut vetem ne nje drejtim, pra ne drejtim te zemres. Kur keto vena jane te semura, vjen si pasoje prishja e kllapave e gjaku mbetet ne kembe. Kjo shoqerohet me vena te dukshme te shemtuar,kembe te enjtura me teper ne darke, mpirje te kembave etj.

Operacioni i venave ka per qellim heqjen, Stripping, e ketyre venave kryesore si dhe te degeve anesore te tyre. Operacioni fillon me infiltrimin e nje lengu anestetik pergjate venave te semura e me pas behet nderprerja e ketyre venave me sistemin e thelle te venave e me pas futet nje sonde ne keto vena e cila nxirret ne piken me te poshtme te insuficiences dhe kryhet heqja, stripping, i tyre. Operacioni behet me anestezi te pergjithshme, spinale apo lokale , ne vartesi te grades se semundjes.

Pas operacionit ,venezat e vogla te lekures mund te zhduken nepermjet sklerotizimit, pra duke injektuar direkt ne keto veneza nje preparat qe i shkaterron ato. Pas operacionit eshte e domosdoshme mbajtja e bandazheve elastike apo corapeve komprimuese qe nuk lejojne krijimin e hematomeve pas operacionit

Kanceri i gjirit

Kanceri i gjirit eshte nje semundje shume e perhapur te grate e cila ne vitet e fundit per fat te keq po gjen nje perhapje gjithmone e me te gjere. Ne vitet e fundit ka nje perparim shume te madh ne drejtim te metodave te operacioneve te kancerit te gjirit.

Nje nga keto eshte "sentinell node biopsie". Ketu behet fjale per gjetjen e nodulit limfatik ne sqetull i cili eshte pergjegjes per kete tumor.

Gjate operacionit behet ekzaminimi histologjik i nodulit limfatik e ne rast se ai eshte pa tumor nuk eshte me e nevojshme te hiqen te gjitha nodulet limfatike te sqetullës , gje qe redukton shume dhimbjet pas operacionit e me tutje eviton fryrjen e kraheve si pasoje e mos rrjedhjes se lengut limfatik nga krahu.

Mundesia e ekzaminimit te tumoreve gjate operacionit ben qe te mos behet heqja e kompelte e gjirit po vetemee tumoritdhe e nje shtrese te shendoshe perreth tij. Klinika jone eshte e pajisur me nje aparat modern , "Mikrotom" ,i cili jep mundsine e kryerjes

se ketyre ekzaminimeve gjate operacionit, ex tempore. Ne ekipin tone te kirurgeve jane disa specialiste shume te mire te ketyre opeacioneve me emer edhe ne Viene.

Kirurgjia plastike

Ne kete klinike kryhen operacione te shumllojshme plastike e estetike.

Ketu futen permiresime cikatrice te shemtuara, hernie te medha te barkut, heqje te lekures se teperme te barkut pas humbjeve te medha te peshes trupore, heqje e dhjemit te nenlekures me metoden e thithjes (liposuktion), zvogelim ose ngritje e gjoksit , zmadhim gjoksi, rregullim te vesheve, te kapakeve te syve, lifting e fytyres, etj.

- Cikatrice Zvogelim gjoksi
- Liposuktion (heqje e dhjemit)
- Abdominoplastik(heqje e lekures se barkut)
- Blefaroplastik (Kapakete syrit)
- Ulcus cruris (Defekte te lekures ne kembe)
- Zmadhim gjoksi

Struma

Gjendra tiroide eshte nje organ shume i rendesishem hormonal pergjegjes per prodhimin e jodit ne trupin e njeriut, element ky shume i domosdoshem per aktivitetin e rregulltmetabolik te trupit.

Ne rastet e mungeses se jodit ne trup , vjen nje zmadhim i kesaj gjendre e cila duke rritur volumin kerkon te kompesoje sasine e jodit qe mungon. Ne faza me te perparuara krijohet nje fryrje e madhe e tiroides qe quhet struma e tiroides e cila ne ratse te rralla arrin ne per masa shume te medha krijon komplikacione. Ne te tilla raste eshte e nevojshme te kryhet nje operacion per zvogelimin e mases se gjendres. Nje semundje tjeter e kesaj gjendre jane tumoret. Keto jane qendra autonome, pra kokra brenda gjendres qe diagmostikohen nepermet ekografise dhe shintigrafise. Dallojme:- kokra te "ngrohta" te cilat kane ne permbajteje jod te shtuar e jane pergjegjese per nje mbifunkcion te gjendres. Si rregull ne keto raste mjaft nje trajtim medikamentoz per te arritur sherimin ;- kokrat e "ftohta" nuk marrin jod e per kete jane suspekte , te dyshueshme, pasi ne to mund te fshihet edhe nje tumor qofte ky i natyres benigne apo maligne. Ne keto raste eshte i domosdoshem operacioni per heqjen e kesaj kokre ose te te gjitha gjendres tiroide dhe ekzaminimi histologjik per te bere trajtimi pasoperacionit.

Kirurgjia e dores

Me kirurgjine e dores futen operacione te ndryshme. Mund te permendim raste te infektimit te rrenjes se thonjve, panaricium, ku eshte i nevojshem drenimi i abscesit. Nje semundje tjeter e perhapur eshte kontraktura Dupuytren, qe konsiston ne trashjen e lekures ne pellemen e dores e cila me avancimin e semundjes sjell nje kontrakture te gishtave deri ne perthyerjen e tyre perfundimtare e mos lejimin e hapjes se dores. Nje semundje tjeter e shpeshte e shpesh e padiagnostikuar eshte " sindromi i tunelit carpal". Ne kete rast pacientet ankohen per mpirje te gishtave te dores sidomos te gishtit te madh e atij te II e te III. Simptomat jane me te theksuara naten. Nepermjet nje operacioni i cili konsiston ne prerje ne nje ligamenti i cili shtyp nevin kryesor te dores , arrihet clirimi i ketijnervi esherimin e semundjes.

Ortopedi

Ne klinike kryhen operacione te ndryshme ortopedike. Nga me kryesoret permendim artroskopine e gjurit e te shpatulles ne rastet e semundjeve ose traumatizimeve te ketyre artikulacioneve (p.sh. demtim i meniskut, ligamenteve etj).

Operacione te gishtave te kembes jane per me teper te gishtit te madh i cili shume shpesh te grate ne moshe te thyer merr nje pozicion te shtrember, hallux valgus, e ka nevojte per nje operacion gjate te cilit kryhet prerje e kockes e vendosja e gishtit ne pozicion te drejte. Po keshtu behet edhe rregullimi i gishtave te tjere te kembes kur ato kane nje pozicion te perthyer, te ashtuquajturit "gishta cekic", qe shkaktojne dhimbje ne artikulacion.

Operacione me te shpeshta jane edhe heqja e kallove nga shputa e kembes. Keto operacione kryhen si rregull nen anestezi lokale e pacientet largohen pas operacionit per ne shtepi..

Me shume sukses jane kryer operacione te demtimeve te ligamenteve te gjurit tek sportiste aktive te cilet mund ti kthehen aktivitetit sportiv pas nje terapie fizioterapeutike rreth 3-6 mujore.

Ne klinike kryhen nderhyrje kirurgjike si vendosja e protezave kokso-femorale, te gjurit dhe te shpatulles. Nje ekip ortopedesh i asistuar nga nje kompani prestigjioze austriake te protezave te cilet sjellin ne klinike jo vetem protezat por edhe gjithe instrumentat e nevojshme, do te beje implantimin e protezave te pacientet me demtime kronike te artikulacioneve. Paciente do te qendrojne mesatarisht 1 jave te shtruar ne klinike dhe do te asistohen nga nje ekip i kompletuar mjekesh e infermieresh.

Aktiviteti Ambulator

Endoskopi

Nepermjet kesaj metode moderne e shume efektive do te behet ekzaminimi i stomakut e i zorres se trashe.

Ne kete menyre behet diagnostikimi e semundjeve inflamatore apo tumoroze, behet heqja e polypeve, merren biopsi per analiza histiologjike, percaktohet terapia medikamentoze.

Ekzaminimi behet ,ne rast se desherohet, edhe me nje gjilpere qetesuese qe lejon pacientet te relaksohen e te mos ndjejne dhimbje gjate ekzaminimit.

Ekografi



Me metoden e ultravaleve behet ekzaminimi i organeve te barkut, te varizeve, tiroides, tumoreve te gjurit. Kjo metode eshte e nje rendesie te pa zevendesueshme per diagnostikimin e gureve te temthit, insuficiencen e variceve (damareve), masave tumorale te gjurit e te gjendres tiroide. Me kete metode nuk ka depertim rrezatimi te demshem ne trupin e njeriut.

Konsulta mjekesore

Gjate aktivitetit të ambulancës do të behen konsulta kirurgjikale gjatë të cilave do të mblidhet historia e sëmundjes së pacientit, vendoset diagnoza, organizohen terminet për operacione e kryhen vizitat e nevojshme. Gjatë kësaj konsulte pacientit i jepet mundësia të bisedojë drejt për drejt me kirurgun, ortopedin apo gjinekologun mbi ankesat e shqetësimet e tij.

Operacionet ambulatorë

Në këtë mënyrë do të operohen të gjithë nishanet, tumore dhjamore të nënlekuren, gjendra dhjamore të infektuara, plastike e vesheve, cirkumcizio (synet), thonjtë e gishtave të dorës ose të këmbës të infektuar, kallo, e tjere. Pacientet do të largohen për në shtëpi të drejtë pas operacionit.

Për fat të keq ekziston një besim i gabuar e trashëguar nga e kaluara se nishanet nuk duhen ngacmuar sepse mundet të nderrojnë natyrë e të behen malinjje. Kjo nuk është aspak e vërtetë e është një mendim që takohet vetëm në Shqipëri e Turqi. E vërtetë është se sa më parë që të hiqet një nishan në kufi të shëndoshe aq më pak mundësi ekziston që ky nishan të malinjzohet.

Në pjesën dermuese të rasteve operacioni është njëkohësisht edhe shërimi, cilado qoftë natyra e tumorit.

5. Pershkrim te shkurter te elementeve te listuar ne formularin informues

Ankesi 2: Përshkrimi i instalimit/implantit, njësitë e tij teknike dhe aktivitetet /veprimtaritë e lidhura drejtpërdrejt me to

Në këtë klinike kryhen të gjitha ndërhyrjet e kirurgjisë së përgjithshme. Si kirurgjia e hernieve, variceve, hemorroideve (me një metode të re pa plage të jashtme e pa dhimbje), kolecista me metoden laparoskopike, struma e gjëndrës tiroide, kirurgjia e kancerit të gjirit.

Kirurgjia plastike si: heqje dhjami me liposuktion, heqje e lëkurës së tepërt të barkut, zvogëlim ose zmadhim të gjoksit, lifting të fytyrës etj. Ndërhyrje ortopedike si: artroskopi të gjurit dhe e shpatullës, gishta e shtrembër të këmbëve, ndërhyrje në dorë, proteza kokso femorale të gjurit dhe të shpatullës, riparimi i kërcit me nje metode moderne.


Gjithashtu kryhen dhe ndërhyrje ORL si korigjimi i deviacionit dhe estetik të hundës, paracenteza, etj.

Klinika ka:

- 10 shtreter



- 2 salla operacioni



- 1 salle reanimacioni
- 1 dhome ambulatorie



- 1 dhome/aparat radiografie



- 1 ambjent/dhome masazhesh

Ne lidhje me mbetjet qe dalin nga diagnostikimi, trajtimi i pacienteve ne sallat e operacionit dhe ato te reanimacionit, klinka ka lidhur nje kontrate me Spitalin Ushtarak per grumbullimin dhe transportin e mbetjeve spitalore dhe trajtimin e tyre ne autoklaven qe Spitali Ushtarak disponon.

Ankesi 3: Menaxhimi i instalimit

Personeli i klinikes

Ekipi i kirurgeve perbehet nga kirurge te mirenjohur austriake. Te gjithë me nje eksperience mbi 20 vjecare pune, kirurge aktive ne kryesisht ne Viene dhe Graz me nje aktivitet pune mbi 1000 paciente ne vit.

Personeli i mesem mjeksor eshte krejtesisht shqipetar. Nje kombinim ndermjet infermiereve te reja e atyre me eksperience do siguroje mbarvajtjen ne aktivitetin ditor ne klinike. Disiplina e punes austriake do te jete modeli te cilin ne do te ndjekim.

Stafi Mjeksor:

- Dr. Arben Kuçani – Shef i Klinikes
- Dr. Thomas Passzisnyeck – Ortoped
- Dr. Stefan Karathanassis – Orotino laringolog
- Dr. Artur Mensdorff Pouilly – kirurg
- Dr. Arben Kerçiku – Mjek Anestezist
- Dr. Lindita Agolli – Mjeke Anesteziste
- Dr. Lorena Shtino – Mjeke e Pergjithshme
- Dr. Erion Peci – Kirurg
- Florinda Toçilla – Infermiere pergjegjese e salles
- Orgerta Turja – Pergjegjese e ambulances

Gjithashtu Klinika ka edhe Stafin Ndhimes:

- Besnik Domi – Mirembajtje te pajisjeve
- Fatmir Balliu – I ngarkuar me menaxhimin mjedisor dhe te cilesise se mjedisieve te klinikes

Aneksi 4. Lëndët e para dhe materialet dytësore, materiale të tjera dhe energjia e përdorur ose e gjeneruar në impiant/instalim

Ne kete klinike, perdoren medikamente mjeksepre per sellen e kirurgjise dhe trajtimit ne reanimacion. Seti i pajisjeve te kirurgjise eshte nje aset tjetër i klinikes



Klinika eshte e pajisur me dy autoklava per sterilimizimin e steve te kirurgjise.



Materiale te tjera kane te bejme me perdorimin e energjise per funksionimin e pajisjeve dhe ndricimit dhe ne teresi per te gjitha nevojat e tjera ne lidhje me ajrin e kondicionuar dhe sistemet e ventilimit.

Ankesi 5. Trajtimi/menaxhimi i materialeve, mbetjeve

Materialet mjeksore ruhen ne magazinën e posaçme per kete qellim dhe nxirren nga magazina sipas kerkeses se rasteve qe paraqiten ne klinike. Sic edhe theksuam, trajtimi i mbetjeve spitalore te natyrave te ndryshme eshte zgjidhur nepermjet nje kontrate me Spitalin Ushtarak. Trajtuesi i mbetjeve ka vene ne dispozicion edhe infrastrukturen grumbulluese te ketyre mbetjeve si kosha dhe kuti te posaçme



Kosh per transportin e mbetjeve

Ankesi 6. Shkarkimet

1. Nuk ka shkarkime ne ajer, pervec rasteve kur vihent te pune ne Gjeneratori i Emergjences ne rastet e nderprerjes se furnizimit me energji elektrike nga rrjeti kryesor. Gjeneratori eshte silencios dhe i pajisur me marmite katalitike.
2. Nuk ka shkarkime fluruese
3. Shkarkimet e ujrave te perdoruara ne klinike, kryesisht aty te larjes dhe tualeteve behen ne rrejtin kryesor te Kanalizimeve te qytetit. ne rrugen "Njazi Demi" Nr.1,
4. Nuk ka shkarkime ne toke
5. Nuk ka leshime te zhurmave ne ambjen. Rasti i perdorimit te gjeneratorit te emergjences eshte zgjidhur me perdorimin e nje gjeneratori super silencioz per shkak edhe te kerkesave qe ka per qetesi ne klinike.
6. Nuk ka vibracionie.
7. Nuk ka burime rrezatimi jo jonizuese

6. Permbledhje jo-teknike te Raportit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis ne nivel kombetare ose nderkombetar kur kerkohet procedura e VNM-es.

Mbeshtetur ne Ligjin Nr.10440, date 07.07.2011 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis", referuar dhe aktivitetit dhe natyres se tij, mbeshtetur ne aktivitete e listuara ne Shtojcen 1, dhe Shtojcen 2, nuk kerkohet qe aktiviteti qe kryhet ne klikien ti nenshtrohet hartimit te Raportit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis.

7. Konsultime nderkufitare kur kerkohen sipas legjislacionit ne fuqi

Projekti i propozuar nuk zhvillohet ne zone nderkufitare, ndaj dhe nuk i nenshtrohet konsultimeve nderkufitare.

8. Autoriteti vendimmarres per dhenien e aktit te miratimit te lejes se mjedisit, procedurat dhe afatet qe do te ndiqen

Referuar percaktimit te bere ne piken 1 te kesaj kerkese dhe mbeshtetur ne Ligjin Nr.10488, date 14.07.2011 "Per lejet e Mjedisit", percaktuam llojin e lejes mjedisore: Leje Mjedisore tipi B.

Mbeshtetur ne Ligjin Nr.10488, date 14.07.2011, nenin 4 – Sistemi i lejeve te mjedisit, pika 1-b, percakton: leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë percaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji;

pika 2, percakton:

Autoritetet kompetente për lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C janë si më poshtë:

- a) **Qendra Kombëtare e Licencimeve (QKL)** është autoriteti ku bëhet kërkesa dhe ku lëshohet leja e mjedisit të tipit A, B dhe C;*
- b) Ministri është autoriteti që firmos aktin e miratimit të lejeve të mjedisit të tipit A dhe B, pasi ato të shqyrtohen dhe përgatiten nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit;*
- c) Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti që verifikon saktësinë e informacionit të dhënë nga operatori në kërkesën e tij për leje mjedisi të tipit A dhe B dhe që i jep mendimin e argumentuar ministrit për dhënien ose jo të kësaj lejeje, me kushte të detajuara, të shkruara, të cilat lëshohen nga QKL-ja;*

Ne lidhje me procedurat dhe afatet per marrjen e lejes se tipit "B", duhet t'i referohemi VKM Nr. 419, date 25.06.2014 "Per miratimin e kerkesave te posaçme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipit A, B dhe C".

VKM Nr.419, date 25.06.2014, Kreu III, – Procedurat per shqyrtimin e kerkesave dhe percaktimi i kushteve per leje mjedisi te tipit B percakton proceduren si me poshte:

1. Kërkuesi që aplikon pranë QKL-së për pajisjen me leje mjedisi të tipit B duhet të dorëzojë këto dokumente:

- a) Formularin informues për pajisje me leje mjedisi të tipit B, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur këtij vendimi;*
- b) Mandatpagesën për tarifën përkatëse për lejen e mjedisit të tipit B, sipas nenit 25 të ligjit nr.10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit";*
- c) Çdo informacion tjetër që kërkuesi i lejes kërkon të merret parasysh gjatë shqyrtimit të aplikimit;*
- ç) Kopjen e vendimit të AKM-së për VNM-në paraprake ose kopje të deklaratës së ministrit për VNM-në e thelluar, të shoqëruar me raportin paraprak ose të thelluar të VNM-së, në rastet kur për instalimin është kryer procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas percaktimit në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis".*
- d) Raportin mbi sigurinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e rreziqeve nga aksidentet madhore, kur kërkohet.*
- dh) Relacionin rreth dëgjësës me publikun, sipas percaktimit në pikën 13 të kreut VI të këtij vendimi.*

2. AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit për leje mjedisi të tipit B nga QKLja, dërgon një kopje të aplikimit në institucionet e mëposhtme, të cilët japin mendimin e tyre, me shkrim dhe në formë elektronike, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune:

- a) Drejtoritë teknike në Ministrinë e Mjedisit, sipas specifikave të instalimit;*
- b) Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave (ISHMPU);*
- c) Agjencinë Rajonale të Mjedisit (ARM).*

3. Nëse institucionet e përcaktuara në pikën 2, të këtij kreu, nuk shprehen brenda afatit, AKM-ja vijon me procedurën.

4. AKM-ja, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, pas verifikimit për saktësinë e dokumentacionit të aplikimit për lejen e mjedisit të tipit B dhe mbledhjes së mendimeve nga publiku e institucionet e përmendura në pikën 2, të këtij kreu, harton aktin e miratimit/refuzimit për dhënien ose jo të lejes së mjedisit të tipit B, të shoqëruar me argumentet përkatëse, dhe e dërgon tek ministri.

5. Ministri, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes, firmos aktin e miratimit/refuzimit të lejes së mjedisit të tipit B ose ia kthen praktikën AKM-së për shtesa apo ndryshime të këtij akti, të shoqëruar me argumentet përkatëse.

6. AKM-ja, brenda afatit të përcaktuar në këtë vendim, publikon vendimin e miratimit ose të refuzimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve për leje mjedisi të tipit A.

Refereuar pikes 1, dh) te ketij kreu – per te bere te mundur aplikimin per leje mjedisi ne QKL, kerkohet te hartohet relacioni per degjesen me publikun sipas percaktimeve te bere ne piken 13, Kreun VI i ketij vendimi:

13. Kërkuesi, kur aplikon për leje mjedisi të tipi A dhe të tipit B, harton një relacion rreth dëgjësës me publikun dhe palët e interesuara dhe e dorëzon në QKL.

Kreu VI i këtij vendimi, percakton procedurat e indormimit dhe pjesmarres se publikut per aplikimin per leje mjedisi te tipit A dhe B, si me pohste vijon:

1. Kërkuesi, përpara aplikimit në QKL, dërgon në AKM, në njësinë e qeverisjes vendore (NJQV) dhe Agjencinë Rajonale të Mjedisit (ARM) ku do të ketë vendndodhjen instalimi një njoftim, me shkrim dhe në formë elektronike (CD, DVD), për aplikimin që do të kryejë për t'u pajisur me leje mjedisore të tipit A ose B, në të paktën 20 kopje elektronike për secilin institucion.
2. Njoftimi duhet të përmbajë këto të dhëna:
 - a) Informacion nëse kërkesa do të jetë për "Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B" apo "Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B".
 - b) Të dhënat e ekstraktit të QKR-së;
 - c) Adresën e vendndodhjes së instalimit;
 - ç) Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim;
 - d) Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues;
 - dh) Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkuftar, kur kërkohet procedura e VNM-së;
 - e) Konsultimet ndërkuftare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi;
 - ë) Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen;
 - f) Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit.
3. AKM-ja publikon, në faqen e saj të internetit, njoftimin sipas pikës 2 të këtij kreu, për të paktën 20 (njëzet) ditë kalendarike, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit.
4. Pas publikimit të njoftimit në faqen e internetit të AKM-së, kërkuesi publikon në, të paktën, një gazetë të zonës ku do të ushtrohet veprimtaria dhe në një gazetë kombëtare njoftimin për aplikimin, duke iu referuar për informacion më të hollësishëm faqes së internetit të AKM-së. Njoftimi publikohet në, të paktën, dy numra të njëpasnjëshëm të secilës gazetë.

5. Njoftimi në gazetë duhet të përmbajë, të paktën:
 - a) llojin e instalimit/veprimtarisë;
 - b) emrin e personit fizik/juridik;
 - c) adresën e vendndodhjes së instalimit;
 - ç) adresën e internetit ku është publikuar njoftimi dhe adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit.
6. NJQV-ja (bashkia apo komuna), në territorin e së cilës do të jetë vendndodhja e instalimit, pasi merr njoftimin sipas pikës 2, të këtij kreu, e publikon në një vend të dukshëm në mjediset e saj për të paktën 20 (njëzet) ditë.
7. Publiku ka të drejtë të konsultojë në mjediset e NJQV/AKM/ARM dhe të kërkojë një kopje të njoftimit, sipas pikës 2, të këtij kreu, nga NJQV/AKM/ARM, pa pagesë.
8. Publiku mund të bëjë komente, me shkrim ose në mënyrë elektronike, mbi njoftimin për leje mjedisi të tipit A në adresën e AKM-së brenda afatit 20-ditor të publikimit.
9. Në përfundim të afatit 20-ditor, kërkuesi, në bashkëpunim me AKM-në dhe NJQV-në, brenda 25 (njëzet e pesë) ditëve organizon një dëgjësë me publikun dhe palët e interesuara, përfshirë OJF-të.
10. Njoftimi për dëgjësën me publikun shpallet gjatë 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve:
 - a) në radio ose TV dhe gazetën vendore;
 - b) në faqen e internetit të AKM-së dhe NJQV-së;
 - c) në tabelën e njoftimeve, në një vend të dukshëm në mjediset e NJQV-së dhe ARM-së së qarkut përkatës.
11. Njoftimi duhet të shoqërohet me:
 - a) llojin e instalimit/veprimtarisë;
 - b) emrin e personit fizik/juridik;
 - c) adresën e vendndodhjes së instalimit;
 - ç) vendin ku gjendet kopja e njoftimit në NJQV-në dhe adresën elektronike të AKM-së ku është publikuar njoftimi.
 - dh) përcaktimin e vendit, të datës dhe orës së organizimit të dëgjësës me publikun.
12. Procesverbalit i dëgjësës mbahet nga kërkuesi dhe nënshkruhet nga pjesëmarrësit në dëgjësë. Kopje të procesverbalit u vihen në dispozicion publikut, palëve pjesëmarrës në dëgjësë, NJQV-së dhe AKM-së.
13. Kërkuesi, kur aplikon për leje mjedisi të tipi A dhe të tipit B, harton një relacion rreth dëgjësës me publikun dhe palët e interesuara dhe e dorëzon në QKL.
14. Shpenzimet e organizimit të dëgjësës mbulohen nga kërkuesi.
15. AKM-ja, gjatë hartimit të aktit të miratimit të lejes së mjedisit të tipit A dhe B, merr parasysh çdo koment, informacion, analizë apo mendim të paraqitur nga publiku që vlerësohet i vlefshëm dhe argumenton arsyet kur ato nuk janë marrë parasysh.
16. AKM-ja, kur e gjykon të arsyeshme, delegon ARM-në e qarkut përkatës për të marrë pjesë në dëgjësën me publikun.

Ne kuader të kesaj kerkese te sipercituar kemi filluar kete procedure te informimit dhe konsultimit me publikun per veprimtarine e propozuar te prodhimit te pelletit.

9. Adresen e AKM-es ku publiku mund te dergoje komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo ne forme elektronike, brenda 20 diteve nga data e njoftimit.

Autoriteti shteteror ku mund te dergohen komentet dhe sugjerimet per sa perskruhet ne kete kerkese per informim dhe konsultim te publikut eshte:

Agjencia Kombetare e Mjedisit (AKM)

Adresa: Rr. "Sami Frasheri", Nr.4, Tirane
Tel & Fax: 04 2 371 237
www.akm.gov.al
e-mail: info@akm.gov.al

Kerkuesi,

"Spitali Kirurgjik Austriak" Sh.p.k.

Astrit Kuçani

Perfaqesues Ligjor